

SH.F. "Sande Shterjoski" - Kërçovë

MISIONI I SHKOLLËS

Shkolla jonë ofron arsimim bashkëkohor dhe edukim të gjeneratave të reja si parakusht për inkuadrim të suksesshëm dhe produktiv në jetën dhe punën e bashkësisë shoqërore.


VIZIONI I SHKOLLËS

Duam që shkolla jonë të jetë mjedis i sigurt dhe i disiplinuar në të cilën nxënësit do të vijnë me kënaqësi, për shkak se në të mësimi do të jetë bashkëkohor, efikas, cilësor dhe i përshtatshëm për nevojat dhe interesat e nxënësve, arsimtarëve dhe shtetit.

MOTOJA

Shkolla jonë hap mundësi të funksionojë sipas dëshirës së fëmijës.

- Respekt më të madh duhet të kemi ndaj fëmijës që e edukojmë;
- Në shkollën tonë të gjithë nxënësit janë të ndryshëm, por përsëri janë të barabartë;
- Mësimi na pasuron dhe na aftëson për atë çka na pret në jetë.



Shkollë e dallimeve që troket me zemër të barazisë multikulturore dhe arsimit cilësor



Lulzim Mehmedi 02.07.1972, Kërçovë

Fakulteti Pedagogjik

"Shën Kliment Ohridski" – Shkup

Profesor i diplomuar

Magjistrant-Menaxhmenti në arsim

PARTNERËT

- KËSHILLI I PRINDËRVE
- KOMUNA E KËRÇOVËS
- MASH, ISHA, BZHA
- USAID-PEP
- UNICEF
- QMEQ
- FISHHM
- AMBASADA JAPONEZE
- OSBE
- Qendra për të drejtat njerzore dhe zgjidhje të konflikteve

BINJAKËZIME

- SH.F "Shaqe Mazreku" -Durrës, Shqipëri
- SH.F " Ilhami Ahmet Ornekal"-Stamboll, Turqi



SH.F "Sande Shterjoski" -Kërçovë

*Shkollë e dallimeve që troket me zemër të barazisë
multikulturore dhe arsimit cilësor*

Fëmija është qendra e kurrikulumit

Të dashur nxënës, të nderuar prindër!

Shkolla jonë hap mundësi të funksionojë sipas dëshirës së fëmijës. Mësimi na pasuron dhe na aftëson për atë që na pret në jetë – prandaj shkolla jonë vazhdimisht përpiqet të krijojë persona të arsimuar dhe të shëndetshëm, si dhe t'i përgatisë nxënësit që të pajisen me dituri themelore, për zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të cilat janë të domosdoshme për vazhdimin e suksesshëm të arsimit dhe jetesës në shekullin XXI.

Shkolla jonë me aktivitete e saja edukativo-arsimore mjaft cilësore, realizon mësim efektiv, krijon klimë pozitive, kujdeset për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve, e përkrah multikulturën, respektimin dhe barazinë gjinore. Nxënësit dhe prindërit marrin pjesë në jetën e përgjithshme, udhëheqjen dhe krijimin e politikave shkollore. Shkolla jonë është e hapur dhe transparente, me qëllime qartë të definuara të cilat e nxisin kreativitetin, të shprehurit e mendimit të lirë, si dhe arritjen e vlerave humane, morale, etike dhe qytetare të personit.

Shkolla ofron mundësi për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të kuadrit arsimor me qëllim që të mundësohet sjellja e risive dhe ndjekja e trendeve moderne në realizimin e procesit edukativo-arsimor. Ndryshimet nuk ndalen vetëm në lëminë e mësimdhënies dhe të mësuarit (nxënies) – shkolla vazhdimisht i përmirëson kushtet hapësinore dhe mjetet materialo-teknike me çka sigurohet zhvillimi i pa ndërprerë i mësimi, njëherit i kushtohet kujdes edhe shëndetit dhe sigurisë së nxënësve në shkollë. Në këtë drejtim, shkolla ka realizuar projekte për renovimin edhe atë:

1. Projekti për rikonstruksionin e çatisë së SHF "Sande Shterjoski", me të cilin në tërësi u ndërrua çatia e vjetër me të re, edhe atë me donacion të Ambasadës Japoneze në Vjenë.

2. Ndërrimi i dritareve të shkollës si pjesë e PEP – projektit (USAID), komponenti për renovimin e shkollave.

3. Modernizimi i arsimit – rikonstruksioni i dyerve në shkollën qendrore, si dhe nyjeve sanitare në shkollën periferike në fshatin Trapçindoll.

Vendosja e përkohshme e kontejnerëve për realizimin e mësimi në fsh. Trapçindoll për shkak të dëmtimit të objektit shkollor, në veçanti çatisë.

Në vijim është **Ndërtimi i objektit të ri shkollor në lagjen Pashinë**, financuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë për arsim dhe shkencë, në kuadër të programit "Ndërtimi dhe rikonstruksioni i shkollave".



Fëmija është qendra e kurrikulumit

Neni 39

Ora mësimore zgjat 40 minuta.

Neni 46

Fëmija në klasën e parë të shkollës fillore regjistrohet në muajin maj për vitin vijues shkollor. Gjatë regjistrimit të fëmijës në klasën e parë, prindi është i detyruar të sjellë vërtetim për vaksinat e marra të obligueshme për fëmijën, i lëshuar nga institucioni kompetent shëndetësor.

Neni 57

Për çdo mungesë të nxënësit në mësimi prindi është i obliguar ta njoftojë udhëheqësin e paraleles për shkaqet e mungesës.

Nxënësi mund të mungojë nga mësimi nëse mungesën e tij prindi paraprakisht e lajmëron në shkollë, por jo më tepër se pesë ditë në vitin mësimor.

Drejtori i shkollës pas kërkesës me shkrim nga prindërit, për shkaqe të arsyeshme mund t'i lejojë nxënësit mungesë më të gjatë nga mësimi, por jo më shumë se 30 ditë.

Neni 59

Ndaj nxënësit që nuk i përmbush obligimet dhe i cenon rregullat e punës edukativo-arsimore, zbatohen masat pedagogjike si vijojnë: vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim, qortim, zvogëlim i sjelljes, zhvendosja e nxënësit në paralele tjetër dhe zhvendosja e nxënësit në shkollë tjetër fillore.

Neni 69

Nxënësi nga klasa e parë duke përmbyllur me klasën, sipas rregullit nuk mund ta përsëritë klasën.

Neni 70

Nxënësi i cili në fund të vitit mësimor në klasën e shtatë, të tetë apo të nëntë ka notë negative deri në dy lëndë, dërgohet në riprovim.

Nxënësi i cili nuk do të kalojë riprovimin nga njëra apo të dyja lëndët, mbetet në klasën e njëjtë.

Nxënësi i cili në fund të vitit mësimor në klasën e shtatë, të tetë apo të nëntë ka më tepër se dy nota negative, mbetet në klasën e njëjtë.



Organizimi i punës edukativo-arsimore në shkollë

Në vitin shkollor 2009/2010 mësimin e ndjekin gjithsej 1587 nxënës, ndërkaq e realizojnë gjithsej 118 arsimtarë.

Ekipin menaxhues e përbëjnë – drejtori i shkollës, ndihmësdrejtori, dy pedagogë dhe dy psikologë. Mësimi zhvillohet në dy objekte shkollore të shkollës qendrore si edhe në dy shkollat periferike katërvjeçare në fshatrat Trapçindoll dhe Mahmute, ndërkaq në prag është ndërtimi i objektit të ri shkollor në lagjen Pashinë i cili parashihet të fillojë me punë nga viti i ardhshëm shkollor. Procesi edukativo – arsimor realizohet në tri gjuhë dhe atë: maqedonisht, shqip dhe turqisht, kurse nga gjuhët e huaja si gjuhë e huaj e parë mësohet gjuha angleze, ndërsa si e dytë mësohet gjuha frënge, gjermane dhe ruse.

Mësimi realizohet sipas planit dhe programit mësimor për shkollimin fillor tetëvjeçar, si dhe planit dhe programit mësimor për shkollimin fillor nëntëvjeçar të Ministrisë për arsim dhe shkencë.

Në aspektin e shkollimit fillor nëntëvjeçar këtë vit shkollor realizohen programe inovative për klasën e katërt, si dhe për klasën e shtatë. Në aspektin e lëndëve zgjedhore, këtë vit shkollor në klasën e pestë mësohen lëndët zgjedhore "Njoftimi me religjionet" dhe "Kultura klasike e civilizimit evropian". Prej klasës së tretë deri në të gjashtë mësohet gjuha rome, në klasën e gjashtë dhe të shtatë mësohen informatika dhe arsimit teknik, ndërsa në klasën e shtatë dhe të tetë në paralelet me mësim në gjuhën maqedonase mësohet gjuha shqipe. Në paralelet me mësim në gjuhën shqipe mësohen lëndët vijuese: informatikë në klasën e gjashtë, të shtatë dhe të tetë, arsim teknik në klasën e shtatë dhe të tetë dhe shkathtësitë jetësore në klasën e gjashtë. Në paralelet me mësim në gjuhën turke informatika mësohet në klasën e gjashtë, kurse gjuha shqipe dhe ekologjia në klasën e shtatë.

Në pajtim me planin dhe programin mësimor në shkollë organizohen edhe aktivitete të lira shkollore, garat shkollore, si dhe aktivitete projektuese me çka stimulohet zhvillimi intelektual i nxënësve.

Gjatë tërë vitit shkollor mbahet llogari për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve nëpërmjet organizimit të ligjëratave për nxënësit me karakter informativ, bashkëpunim me prindërit, bashkëpunim me të gjithë subjektet në shkollë si dhe shërbimin shëndetësor.

Shkolla me sukses bashkëpunon me mjedisin lokal, biznes sektorin dhe sektorin joqeveritar, si dhe me institucionet dhe organizatat tjerat edukativo-arsimore, lokale në realizimin e aktiviteteve të planifikuara. Rezultatet e arritura dhe sukseset promovohen nëpërmjet medimeve të shtypura dhe elektronike me çka popullata rregullisht informohet me punën e përgjithshme të shkollës.



Aktivitetet projektuese

Aktivitet e shumta projektuese që realizohen në shkollën tonë janë karakteristike njohëse që burojnë nga imazhi i shkollës sonë. Punëtoritë, trajnimet dhe aktivitetet nuk janë të fokusuara vetëm në kuadrin arsimor, por edhe në kycjen aktive të nxënësve, prindërve, bashkësisë vendore, sektorit të biznesit dhe sektorit joqeveritar si krijues të përbashkët të ndryshimeve pozitive. Gjatë viteve të kaluara si edhe gjatë këtij viti shkollor janë realizuar:

1. Projekti "Mundësi të barabarta arsimore për fëmijët Rom" (FISHM) – përmirësimi i suksesit të fëmijëve Rom si dhe rritja e shkallës së përfshirjes së fëmijëve në shkollë.

- Metodologjia Hap pas hapi
- Mësimdhënia dhe të mësuarit kreativ
- Arsimitimi për të drejta sociale për të rritur
- Arsimitimi për të drejta sociale për fëmijë

2. Projekti për modernizimin e arsimit

3. PEP-projekti

- Përparimi i notimit
- Përdorimi i TIK në mësim
- Avancimi i matematikës dhe shkencave natyrore
- Përmirësimi i aftësive të punës

4. "Shkollë sipas dëshirës së fëmijës" (UNICEF)

- dimensioni "Notimi formativ"- përparimi i notimit
- dimensioni "Multikultura"- promovimi dhe kultivimi i ngjashmërive kulturore dhe dallimeve në shoqërinë multikulturore
- dimensioni "Participimi"- përfshirja e nxënësve dhe prindërve në procesin e vendimmarrjes në shkollë
- dimensioni "Përfshirje"- përfshirja e të gjithë nxënësve në të gjitha aspektet e jetës dhe punës në shkollë
- dimensioni "Ndjeshmëri gjinore"- promovimi i barazisë gjinore
- dimensioni "Shëndet dhe siguri"- ballafaqimi me lloje të ndryshme të dhunës në hapësirën shkollore dhe jashtë saj.

5. "Kompjuter për çdo fëmijë"

Në vitin shkollor 2009/2010 realizohen aktivitetet vijuese:

- Projekti "Shkolla të gjelbra" (pjesë e PEP-projektit), me të cilin u formua klubi i Gjelbër i shkollës i cili nëpërmjet aktiviteteve të veta e promovon mbrojtjen e mjedisit jetësor.
- Arsimitimi për punësim dhe afarizëm (PEP-projekti) – Integrimi i afarizmit dhe biznes arsimimit në mësimdhënien e përditshme, si dhe zhvillimin e shkathtësive afariste të nxënësit.
- Klubet shkencore të nxënësve (PEP-projekti) – formimi i klubeve shkencore të nxënësve për matematikë dhe grupin e lëndëve natyrore.
- Shkollë sipas dëshirës së fëmijës (UNICEF) – dimensionet „Participim” dhe „Multikulturë”.
- Përfshirjen e arsimimit për shkathtësi jetësore në arsimin lëndorë - pilot programi në klasën e pestë.
- Trajnimi i arsimtarëve të grupit klasor – Tool Kids.
- Shpërndarja e EES –Lap –Top kompjuterëve për arsimtar.



SH.F "Sande Shterjoski" -Kërçovë

Kontakto me ne

11 Shtatori Nr.143

Kërçovë, R e Maqedonisë

Tel: +389 (0)45 225 325

Fax: +389 (0)45 225 325

E-mail: sandesterjoski@gmail.com

web: www.sandesterjoski.tk

